

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË Themelore në Prishtinë/Departamenti i Përgjithshëm, sipas gjyqtares se vetme gjykuese, Fatime Dërmaku, me zyrtaren ligjore Edona Grajçevci, në lëndën penale ndaj të akuzuarit H. J., të cilin sipas autorizimit e mbron avokati A. L., nga P., për shkak të veprës penale Shkelja e urdhërit mbrojtës nga neni 25 të Ligjit nr. 03/L-182 për Mbrojtje nga Dhuna në Familje, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë/Departamenti i Përgjithshëm, PP.II.nr.4659/15 të datës 22.02.2016, të cilën e përfaqësonte prokurorja e shtetit Shenaj Berisha, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor dhe publik, në prezencën e palëve, më datën 30.11.2017, mori dhe publikisht shpalli këtë :

A K T G J Y K I M

H. J., i biri i S. dhe nënës Z., e vajzërisë H., i lindur me *data e lindjes...*, në B., KK P., ku edhe jeton, me nr. personal numri personal..., me nr. të telefonit *numri i telefonit...* ka të kryer shkollën e mesme , i martuar , i punësuar ,i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar shtetas i Republikës së Kosovës, më parë i pagjykuar dhe udhëhiqet procedure për një vepër tjetër penale.

ËSHTË FAJTOR

Sepse me datë 11.08.2015, rreth orës 11:00h, në rrugën "...": në P., ka shkelur Urdhrin mbrojtës të lëshuar nga Gjykata Themelore në Prishtinë, me nr. C.nr. 746/2015, ashtu që, i njëjti duke vepruar në kundërshtim të këtij urdhri, e ka shqetësuar palën e mbrojtur, këtu të dëmtuarën F. J., në atë mënyrë që, e ka ndaluar të njëjtën dhe e ka kapur për dore, duke iu drejtuar me fjalët “veç po du me bisedu”, edhe atë përkundër faktit se e ka pasur të ndaluar t’i afrohet të njëjtës, në vende publike në distancë prej 100m, ndërsa në vendin e punës, në distancë prej 200m,

-me këtë ka kryer veprën penale Shkelja e urdhrit mbrojtës nga neni 25 të Ligjit nr. 03/L-182 për Mbrojtje nga Dhuna në Familje.

Andaj, gjyqtarja e vetme gjykuese, duke u bazuar në dispozitat e lartcekura ligjore dhe në nenet 3, 4, 41, 42, 43, 46, 73,74,75 dhe 76 të KPRK, si dhe nenit 248 dhe nenit 365 të Kodit të Procedurës Penale,¹ të pandehurin H. J., e :

E GJYKON

ME DËNIM ME GJOBË

- Ashtu që të pandehurit H. J., i caktohet dënimi me gjobë në shumë prej 200 € (dyqind Euro), të cilin dënim i pandehuri do ta paguaj pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.
- Nëse i pandehuri nuk dëshiron ose nuk mund të paguajë gjobën, gjykata mund të zëvendësojë dënimin me gjobë me dënim me burgim, ashtu që 1 (një) ditë burgim do të llogaritet me 20 (njëzet) Euro të dënimit me gjobë.
- Detyrohet i pandehuri që të paguajë të gjitha shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë përfundimtare të gjykatës dhe në emër të paushallit gjyqësor shumë prej 20 €.

ARSYETIMI

1.Historiku i procedurës dhe deklarimi i të akuzuarve

Prokuroria Themelore në Prishtinë/Departamenti i Përgjithshëm, të, më datë 22.02.2016, ka ngritur aktakuzën PP.II.nr.4659/15, ndaj të akuzuarit H. J., i lindur në B., KK.P., ku edhe jeton, për shkak të veprës penale Shkelja e urdhrit mbrojtës nga neni 25 të Ligjit nr. 03/L-182 për Mbrojtje nga Dhuna në Familje.

Pas pranimit të aktakuzës, gjyqtarja e vetme gjykuese e ka caktuar shqyrtimin fillestar, për datën 24.10.2017, ku është lexuar aktakuza nga ana e prokurorit të shtetit dhe pas leximit të aktakuzës, i pandehuri ka deklaruar se e ka kuptuar aktakuzën dhe veprën penale për të cilën akuzohet duke shtuar se nuk e pranon fajësinë për kryerjen e kësaj vepre penale.

¹ Kodi i Procedurës Penale (Në tekstin e mëtejme KPP), nr.04/L-123, i datës 13.12.2012, i cili ka hyrë në fuqi më 01.01.2013.

Me datë 14.11.2017, mbrojtësi i të pandehurit av. A. L., ka paraqitur kërkesë për hudhje të aktakuzës, duke i propozuar Gjykatës që të hudh aktakuzën e lartcekur.

Gjyqtarja e vetme Gjykuese, me datë 27.11.2017, me aktvendimin P.nr.890/16, ka refuzuar si të pabazuar kërkesën e mbrojtësit për hudhje të aktakuzës.

Gjykata me datë 30.11.2017, ka caktuar shqyrtimin gjyqësor, ku përsëri është lexuar aktakuza nga ana e prokurorit të shtetit dhe pas leximit të aktakuzës, i pandehuri pas konsultimit me mbrojtësin e tij, ka deklaruar se e ka kuptuar aktakuzën dhe veprën penale për të cilën akuzohet duke shtuar se e pranon fajësinë për kryerjen e kësaj veprë penale e cila i vihet në barrë.

2.Vlerësimi i pranimi të fajësisë

Në shqyrtimin gjyqësor dhe publik, të datës 22.06.2015, gjyqtarja e vetme gjykuese, pas dëgjimit të palëve dhe të mbrojtësit të akuzuarit, ka konstatuar se janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore për pranimin e fajësisë. Në këtë aspekt, gjyqtarja e vetme gjykuese, ka konstatuar se i akuzuari e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi të fajësisë; se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht nga i akuzuari, pas konsultimeve të mjaftueshme, me mbrojtësin e tij, avokatin A. L.; se pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza dhe aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

3.Gjendja faktike e vërtetuar

Andaj, duke u bazuar në këto që u ceken më lartë, kryetari i trupit gjykues e ka vërtetuar këtë gjendje faktike :

-se i akuzuari H. J., me dashje e ka kryer veprën penale Shkelja e urdhrin mbrojtës nga neni 25 të Ligjit nr. 03/L-182 për Mbrojtje nga Dhuna në Familje, në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitivin e këtij aktgjykimi dhe për të njëjtën është përgjegjës.

4.Elementet e veprës penale

Gjyqtarja e vetme gjykuese, e shpalli fajtor të akuzuarin H. J., për shkak të veprës penale Shkelja e urdhrin mbrojtës nga neni 25 të Ligjit nr. 03/L-182 për Mbrojtje nga Dhuna në Familje, ngase veprimet e të njëjtit i përmbajnë të gjitha tiparet e kësaj veprë penale dhe se për të njëjtën është edhe penalisht përgjegjës. Neni 25 të Ligjit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje, inkriminon këdo Kush e shkel në tërësi ose pjesërisht urdhrin për mbrojtje, urdhrin për mbrojtje emergjente ose urdhrin për

mbrojtje të përkohshme emergjente kryen veprë penale që dënohet me gjobë prej dyqind (200) euro deri më dymijë (2000) Euro ose me burgim deri në gjashtë muaj, dhe në rastin konkret në veprimet e tij përmbushen elementet e veprës penale Shkelja e urdhrit mbrojtës nga neni 25 të Ligjit nr. 03/L-182 për Mbrojtje nga Dhuna në Familje, meqenëse sipas dispozitivit të këtij aktgjykimi ai ka vepruar në kundërshtim të këtij urdhri, e ka shqetësuar palën e mbrojtur, këtu të dëmtuarën F. J., në atë mënyrë që, ditën kritike, e ka ndalur të njëjtën dhe e ka kapur për dore, duke iu drejtuar me fjalët “veç po du me bisedu”, edhe atë përkundër faktit se e ka pasur të ndaluar t’i afrohet të njëjtës, në vende publike në distancë prej 100m, ndërsa në vendin e punës, në distancë prej 200m.

5. Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit

Duke u bazuar në nenin 73 dhe 74 të KPRK, me rastin e shqiptimit të dënimit ndaj të pandehurit si dhe nenin 75 dhe 76 zbutjen dhe kufijtë e zbutjes së dënimit, gjyqtarja e vetme gjykuese, i ka marrë për bazë disa rrethana që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit dhe zbutjen apo ashpërsimin e tij. Në këtë aspekt, si rrethanë lehtësuese për të pandehurin, gjyqtarja e vetme gjykuese, i ka marrë për bazë sjelljet e mira të pandehurit gjatë shqyrtimeve gjyqësore; pranimin e fajësisë; se sipas deklaratës së të pandehurit, të cilës gjyqtarja e vetme gjykuese, ja fali besimin, i njëjti është nën terapi për shkak të transplantit të veshkës që ka bërë dhe ka vazhdimisht shpenzime; se i njëjti është penduar për kryerjen e kësaj veprë penale dhe se ka premtuar se në të ardhmen nuk do të kryejë ndonjë veprë tjetër penale; se ka një moshë relativisht të re, dhe deri tani nuk ka qenë i dënuar për ndonjë veprë tjetër penale. Gjithashtu, me rastin e shqiptimit të dënimit me gjobë, gjyqtarja e vetme gjykuese, e ka marrë për bazë sidomos faktin se i pandehuri për shkak të transplantit të veshkës, vazhdimisht duhet të blejë terapinë, ngase e njëjta është e domosdoshme, gjyqtarja e vetme gjykuese, si rrethanë rënduese vlerësoi peshën e veprës penale dhe rrezikshmërinë shoqërore të veprës penale.

6. Shqiptimi i dënimit në harmoni me peshën e veprës penale dhe me shkallën e përgjegjësisë penale të pandehurit dhe qëllimi i dënimit të shqiptuar

Sipas bindjes së gjyqtarës se vetme gjykuese, dënimi me gjobë në shumë prej 200 € (dyqind Euro) ndaj të pandehurit H. J., duke i marrë për bazë rrethanat e përmendura më lartë, është dënim i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë së të pandehurit.

Gjyqtarja e vetme gjykuese, gjithashtu ka konstatuar se me këtë dënim mund të arrihet edhe qëllimi i dënimit, nga neni 41 i KPRK, i cili konsiston në parandalimin

e të pandehurit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij; të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

7. Zëvendësimi i dënimit me gjobë në dënim me burgim

Gjyqtarja e vetme gjykuese, duke u bazuar në nenin 46 të KPRK, ka vendosur që nëse i pandehuri pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nuk dëshiron ose nuk mund të paguajë gjobën, gjykata mund të zëvendësojë dënimin me gjobë me dënim me burgim, ashtu që 1 (një) ditë burgim do të barazohet me 20 (njëzet) Euro të dënimit me gjobë.

8. Vendimi për shpenzimet e procedurës penale

Duke e pasur parasysh kohëzgjatjen e procesit gjyqësor, dhe gjendjen financiare të të akuzuarit, trupi gjykues, duke u bazuar në nenin 451 paragrafi 1 të KPP-së, ka vendosur që të akuzuarin ta detyrojë për ti paguar shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë përfundimtare të gjykatës si dhe paushallin gjyqësore në shumë prej 20 Euro.

Duke u bazuar në këto që u cekën më lart, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË

Departamenti i përgjithshëm

P.nr.890/16

Më 30.11.2017

**Zyrtarja ligjore,
Edona Grajçevci**

**Gjyqtarja e vetme gjykuese,
Fatime Dërmaku**

KËSHILLA JURIDIKE : Kundër këtij aktgjykimi mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e pranimit të të njëjtit. Ankesa në kopje të mjaftueshme i dorëzohet kësaj Gjykate Themelore.